



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 117, datë 05.03.2020

PËR
NXJERRJEN NGA PËRDORIMI TË DISA ASETJEVE DHE TRANSFERIMIN
KAPITAL TË PAJISJEVE TË ZYRAVE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të neneve 61, 95 e 96 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 03.04.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, të Udhëzimit nr. 30, datë 30.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave, si dhe në dokumentacionin e përgatitur për këtë qëllim nga Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të aseteve si më poshtë:
 - automjetin tip “Alfa Romeo 156” me targa TR 0221 Z, prodhim i vitit 2002 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
 - 6 copë motoçikleta të tipit “Loncin” me targa TR 941C; TR 942C; TR 943C; TR 944C; TR 945C dhe TR 946C, prodhim i vitit 2004, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
 - automjetin tip “Volkswagen Bora” me targa AA528 JU, prodhim i vitit 2000, në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
 - motoçikletën tip “Peugeot”, me volum motori 49 cc, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
2. Miratimin e transferimit kapital të pajisjeve të zyrave të ish-Zyrës së Administrimit Gjyqësor në favor të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas pasqyrës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe struktura përkatëse pranë Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR